**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**TIRANË**

**NR. 598 Akti**

**Nr. 5387 VENDIMI**

# VENDIM
# I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë, sot më datë 25. 07. 2018, unë Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Ervin Pollozhani, mora në shqyrtim kërkesën dhe aktet e paraqitura nga kërkuesja Sabina Kodra, e autorizuar nga Asambleja e Përgjithëshme e shoqatës dhe me cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv së shoqatës, **"ALBANIA WOMAN IN AUDIOVISUAL"**, dhe

## KONSTATOVA SE:

Kërkuesja kërkon të regjistrojë si person juridik organizatën jofitimprurëse, **"ALBANIA WOMAN IN AUDIOVISUAL"**, e cila ka formën e një shoqate. Për këtë shkak, përveç kërkesës ajo ka paraqitur për të depozituar edhe Aktin e Themelimit Nr. 3092 Rep. Nr. 1432 Kol. datë 11.07.2018 të përpiluar përpara noteres Mimoza I. Sadushaj dhe Statutin e shoqatës.

**Anëtarë themelues** të shoqatës janë: Sabina Kodra, Ema Andrea, Luljeta Lleshanaku, Suela Zalla, Mira Tuci, Rafaela Rica, Eglantina Cenomeri.

**Shoqata e ka selinë** e saj në adresën: Rruga "M. Shyri", P. 1, Ap. 156, Tiranë, Shqipëri. Shoqata e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Kohëzgjatja e veprimtarisë** të shoqatës është me afat të pacaktuar.

**Qëllimi** i shoqatës është:

1. Promovimi i barazisë gjinore për femrat profesioniste që zhvillojnë krijimtarinë dhe aktivitetin e tyre në fushën e kinematografisë, si dhe në atë audiovizuale e multimediale, në aspektin e formimit dhe krijimit të mundësive për punësim, promovim, etj.
2. Krijimi i një komuniteti solid të profesionistëve në fushën audiovizuale, të cilët ndajnë përvojën e tyre dhe i sigurojnë njëra – tjetrës mbështetje reciproke.
3. Prmovimi i krijimtarisë audiovizive dhe multimediale të anëtarëve të saj, si dhe nga femrat në përgjithësi, bazuar në parimet barazi, solidariteti, ndërtimi i kompetencës dhe shkëmbimi i njohurive.
4. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave artistike dhe ekonomike të anëtarëve të shoqatës, si dhe përfaqësimi i tyre në borde, apo komisione, sic janë Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Radio Televizioni Pulik Shqiptar, etj.
5. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme që promovojnë vlera kulturore dhe artistike dhe janë në funksion të objektit të veprimtarisë së shoqatës.
6. Anëtarësimi në rrjete ndërkombëtare, të cilat kanë objekt të aktivitetit të tyre lancimin e femrës në kinematografi dhe në fushën audiovizuale. Pjesmarrje aktive dhe përfaqësim dinjitoz i femrës shqiptare në audiovizual.

...bështetja e femrave krijuese në audiovizual, nëpërmjet krijimit të mundësive të ...tyre në rrjetet dhe programet e edukimit, trajnimit, apo përfitimeve të natyrës që ... zhvillimin profesional të femrave në sektorin audiovizual dhe mundësojnë shkë... njohurive online dhe offline.

8. Përmirësimi i politikave, strategjive, programeve në fushat e sipërpërmendura për plotës... nevojave të identifikuara të komunitetit të femrave kineaste.
9. Kujdeset vecanërisht për edukimin artistik të anëtarëve dhe artisteve të fushës audiovizu... përmes binjakëzimeve apo mundësive të shumta të shkollimit për femra, me qëllim shtimin artisteve femra të specializuara në fushën audiovizuale e multimediale.
10. Shërbimi ndaj shoqërisë i nismave krijuese të shoqatës për fushata sensibilizuese, artistike, etj.
11. Përfshirja e anëtarësisë së shoqatës, përmes pjesëmarrjes në aktivitete dhe përfaqësimit aktiv të tyre në cështje të fushës audiovizive, por edhe në ceshtje të tjera sensibël jashtë këtij fushe, që kanë lidhje me përditshmërinë tonë.
12. Shoqata nuk do të bdjekë qëllime politike. Ajo do të jetë organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare dhe synon të mbështesë dhe të bashkëpunojë me të gjithë artistet, krijueset dhe producentet në fushën audiovizuale.
13. Nëpërmjet anëtarëve të saj me përvojë mund të organizojë kualifikime, ëorkshop -e, master class, apo aktivitete të tjera për të gjithë të interesuarit që shprehin dëshirën për të patur njohuri mbi filmin, procesin krijues dhe realizues të tij.
14. Përgatitja e projekteve dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme në funksion të projektit edukimi nga dhe përmes kulturës.
15. Projektimi dhe realizmi i anketave, testeve, statistikave, etj., për aktivitetet në fushën e audiovizuallit, si dhe në fusha që kanë lidhje organike me to.
16. Krijimi i një infrastrukture efektive për thithjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit në fushat që janë objekt i aktivitetit të shoqatës.
17. Studimi dhe implementimi i formave bashkëkohore në marketingun e produktit kinematografik dhe audiovizual dhe dhënien e asistencës në këtë fushë për subjektet e interesuara.

**Organet drejtuese** të shoqatës janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Bordi Drejtues;
- Kryetari i Shoqatës.

Kompetencat e këtyre organeve janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqatës.

Bordi Drejtues drejton veprimtarinë e shoqatës dhe përbëhet nga:

1. Suela Zalla
2. Rafaela Rica
3. Sabina Kodra
4. Mira Tuci
5. Ema Andrea

Nga rradhët e Bordit Drejtues zgjidhet Kryetarja i Shoqatës. Kryetare e Shoqatës është zgjdhur ...znj. Sabina Kodra.

Mandati i Kryetares dhe anëtarëve të Bordit Drejtues është 4-vjeçar dhe kanë të drejtë të ...ikandodojnë.

met e të ardhurave financiare dhe materiale të Shoqatës do të jenë:

Kuotizacionet e anëtarëve.

Grante, donacione dhe sponsorizime të ofruara nga subjekte private dhe publike, vendas dhe të

Të ardhura nga veprimtaria ekonomike në përputhje me ligjin, sipas vendimeve të miratuara në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarëve.

Burime të tjera të ligjshme financiare.

Shoqata, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e shoqatës, të parashikuar në statut.

Në këto kushte, çmohet se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe për këtë shkak ajo duhet të pranohet.

## PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në ligjin nr. 8788, datë 03.05.2001 "Për organizatat jofitimprurese" dhe në ligjin nr. 8789 datë 03.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"

## VENDOSA :

1. Pranimin e kërkesës.
2. **Regjistrimin si person juridik të shoqatës "ALBANIA WOMAN IN AUDIOVISUAL".**

   **Anëtarë themelues** të shoqatës janë: Sabina Kodra, Ema Andrea, Luljeta Lleshanaku, Suela Zalla, Mira Tuci, Rafaela Rica, Eglantina Cenomeri.

   Shoqata e ka **selinë** e saj në adresën: Rruga "M. Shyri", P. 1, Ap. 156, Tiranë, Shqipëri. Shoqata e shtrin aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqiperisë.

   **Kohëzgjatja e veprimtarisë** të shoqatës është me afat të pacaktuar.

   **Qëllimi** i Shoqatës është:

- Promovimi i barazisë gjinore për femrat profesioniste që zhvillojnë krijimtarinë dhe aktivitetin e tyre në fushën e kinematografisë, si dhe në atë audiovizuae e multimediale, në aspektin e formimit dhe krijimit të mundësive për punësim, promovim, etj.
- Krijimi i një komuniteti solid të profesionistëve në fushën audiovizuale, të cilët ndajnë përvojën e tyre dhe i sigurojnë njëra – tjetrës mbështetje reciproke.
- Prmovimi i krijimtarisë audiovizive dhe multimediale të anëtarëve të saj, si dhe nga femrat në përgjithësi, bazuar në parimet barazi, solidariteti, ndërtimi i kompetencës dhe shkëmbimi i njohurive.
- Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave artistike dhe ekonomike të anëtarëve të shoqatës, si dhe përfaqësimi i tyre në borde, apo komisione, sic janë Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Radio Televizioni Pulik Shqiptar, etj.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme që promovojnë vlera kulturore dhe artistike dhe janë në funksion të objektit të veprimtarisë së shoqatës.
- Anëtarësimi në rrjete ndërkombëtare, të cilat kanë objekt të aktivitetit të tyre lancimin e femrës në kinematografi dhe në fushën audiovizuale. Pjesmarrje aktive dhe përfaqësim dinjitoz i femrës shqiptare në audiovizual.

- Mbështetja e femrave krijuese në audiovizual, nëpërmjet krijimit të mundësive së tyre në rrjetet dhe programet e edukimit, trajnimit, apo përfitimeve të natyrës që zhvillimin profesional të femrave në sektorin audiovizual dhe mundësojnë shkë njohurive online dhe offline.
- Përmirësimi i politikave, strategjive, programeve në fushat e sipërpërmendura për plotës nevojave të identifikuara të komunitetit të femrave kineaste.
- Kujdeset veçanërisht për edukimin artistik të anëtarëve dhe artisteve të fushës audiovizu përmes binjakëzimeve apo mundësive të shumta të shkollimit për femra, me qëllim shtimin artisteve femra të specializuara në fushën audiovizuale e multimediale.
- Shërbimi ndaj shoqërisë i nismave krijuese të shoqatës për fushata sensibilizuese, artistike, etj.
- Përfshirja e anëtarësisë së shoqatës, përmes pjesëmarrjes në aktivitete dhe përfaqësimit aktiv të tyre në çështje të fushës audiovizive, por edhe në ceshtje të tjera sensibël jashtë kësaj fushe, që kanë lidhje me përditshmërinë tonë.
- Shoqata nuk do të bdjekë qëllime politike. Ajo do të jetë organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare dhe synon të mbështesë dhe të bashkëpunojë me të gjithë artistet, krijueset dhe producentet në fushën audiovizuale.
- Nëpërmjet anëtarëve të saj me përvojë mund të organizojë kualifikime, ëorkshop -e, master class, apo aktivitete të tjera për të gjithë të interesuarit që shprehin dëshirën për të patur njohuri mbi filmin, procesin krijues dhe realizues të tij.
- Përgatitja e projekteve dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme në funksion të projektit edukimi nga dhe përmes kulturës.
- Projektimi dhe realizmi i anketave, testeve, statistikave, etj., për aktivitetet në fushën e audiovizuallit, si dhe në fusha që kanë lidhje organike me to.
- Krijimi i një infrastrukture efektive për thithjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit në fushat që janë objekt i aktivitetit të shoqatës.
- Studimi dhe implementimi i formave bashkëkohore në marketingun e produktit kinematografik dhe audiovizual dhe dhënien e asistencës në këtë fushë për subjektet e interesuara.

**Organet drejtuese** të shoqatës janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Bordi Drejtues;
- Kryetari i Shoqatës.

Kompetencat e këtyre organeve janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqatës.

**Bordi Drejtues** drejton veprimtarinë e shoqatës dhe përbëhet nga:

1. Suela Zalla
2. Rafaela Rica
3. Sabina Kodra
4. Mira Tuci
5. Ema Andrea

Nga rradhët e Bordit Drejtues zgjidhet Kryetarja i Shoqtës. Kryetare e Shoqatës është zgjdhur Sabina Kodra.

Mandati i Kryetares dhe anëtarëve të Bordit Drejtues është 4-vjeçar dhe kanë të drejtë të rikandodojnë.

Burimet e të ardhurave financiare dhe materiale të Shoqatës do të jenë:

zacionet e anëtarëve.

...nte, donacione dhe sponsorizime të ofruara nga subjekte private dhe publike, vendas dhe të

...ë ardhura nga veprimtaria ekonomike në përputhje me ligjin, sipas vendimeve të miratuara në ...ajën e Përgjithshme të Anëtarëve.

Burime të tjera të ligjshme financiare.

Shoqata, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, të realizojë të ...dhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e shoqatës, të parashikuar në statut.

3. Të bëhen pasqyrimet përkatëse në Zyrën e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Tirane me dt. 25. 07. 2018 !**

**GJYQTAR**

**ERVIN POLLOZHANI**

PULLE TARIFE
200
LEKE
R.SHQIPERISE